



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 5 regjistër (JR)
Datë 21.01.2021

Nr. 24 i vendimit
Datë 21.06.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 21.06.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Albano Çepele, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 317, datë 20.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet D dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; dhe neni 49 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit Albano Çepele të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve, dhe përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rihetim ose ndryshimin e vendimit nr. 317, datë 20.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke u zbatuar prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit nga detyra shoqëruar me detyrimin për kontroll mjekësor, sipas kërkesave të Shkollës së Magjistraturës, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Albano Çepele (në vijim “subjekti i rivlerësimit” ose “subjekti”), në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjin nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹. Duke qenë se ushtronte këtë funksion, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 16, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Komisioni administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe kreu procesin e rivlerësimit bazuar në të tri kriteret e vlerësimit.
 - 2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, referuar deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit *vetting*, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar dhe mosdeklarim pasurie*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; dhe (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit*.
 - 2.2. DSIK-ja, pas procedurës së kontrollit të kriterit të figurës, konstatoi *papërshtatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.
 - 2.3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi kreu procedurën përkatëse të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, i dërgoi Komisionit raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 317, datë 20.11.2020, pasi kreu procesin e rivlerësimit për të tria kriteret, Komisioni vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe atë të aftësive profesionale, duke konkluduar se: (i) *ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për*

¹ Referuar shkresës së dosjes personale të subjektit, përcjellë me raportin e KLGj-së – është emëruar në detyrën e gjyqtarit më datë 24.01.1998.

kontrollin e figurës dhe pasurisë; (ii) rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale; (iii) nga vlerësimi tërësor, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

3.1. Për vlerësimin e pasurisë, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit:

- i. Nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, por nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* se burimi për blerjen e apartamentit në Tiranë ka qenë huaja nga e motra dhe nuk provoi mundësinë financiare të huadhënëses në shumën 30.000 euro, duke e vënë atë në pozitën e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Nuk ka deklaruar qartësisht dhe me dokumentacion mbështetës, marrëdhënien e pronësisë me apartamentin me sipërfaqe 63 m², të ndodhur në Fier, duke e vënë sërish në pozitën e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

3.2. Për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit:

- i. Ka treguar gabime thelbësore dhe serioze, si dhe një seri të qartë e të vazhdueshme gjykimesh të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, vonesa dhe zvarritje të gjykimeve, që çojnë në cenim të të drejtave të palëve në proces, si dhe nuk është efektiv. Të gjitha këto të meta të konstatuara në vlerësimin profesional të subjektit, vlerësohet se cenojnë besimin e publikut te një gjyqtar.
- ii. Subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm, në kuptim të germës “c”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka treguar cilësi të papranueshme në punë në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

III. Shkaqet e ankimit

A. Parashtrimet në ankim

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e tij [vendimit] dhe konfirmimin në detyrë. Në ankim, subjekti pretendoi se vendimi i Komisionit është i pabazuar në ligj dhe përbën shkelje të normave dhe rregullave për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por edhe vlerësim të gabuar të rrethanave faktike që rezultuan të vërtetuara gjatë procesit administrativ, për hetimin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë.

4.1. Shkaqet me natyrë procedurale

Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në lidhje me:

- i) shprehjen e gjendjes në situatën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës gjykuese;

- ii) mohimin e të drejtës për t'u njohur me dosjen² edhe pas një kërkesë të avokatit në seancën dëgjimore, si element i mbrojtjes nga një përfaqësues i aftë; si dhe
- iii) diskriminimin për shkak të sëmundjes, pasi për shkak të saj, nuk ka pasur mundësi të siguronte provat.

4.2. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë

- i) Subjekti pretendoi se nuk ka në pronësi ose përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Pasuria e tij nuk përbën dyfishin e pasurisë së ligjshme, ndaj nuk mund të shkarkohet.
- ii) Sa i takon apartamentit të banimit në Tiranë, subjekti pretendoi që nuk janë marrë të gjithë provat në shqyrtim, prandaj kërkoi të riçelet hetimi gjyqësor dhe të administrohen provat si: një kontratë klingeru për apartamentin e Tiranës, që subjekti do ta depozitojë në Kolegj; të hetohet nga Kolegji gjendja pasurore e A. dhe E. Gj., si dhe të pranohet se të ardhurat që shërbyen janë nga shoqëria tregtare e bashkëshortit të motrës.
- iii) Sa i takon apartamentit të fituar me privatizim në Fier, subjekti kërkoi administrimin e provave të reja. Sipas tij, apartamenti është shitur dhe është i braktisur, të paktën që në vitin 1995.
- iv) Për shpenzimet spitalore të nënës, në vlerën 9.960 euro, subjekti pretendoi se janë paguar nga e motra, në kuadër të marrëdhënieve familjare dhe kërkoi të administrohet ekstrakti historik i shoqërisë “{***}” ShPK, pasi, sipas tij, vërtetohet pasuria e ligjshme e familjes së motrës.

4.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aspektit të aftësive profesionale

- i) Subjekti pretendoi që procesi i rivlerësimit nuk ka mbajtur në konsideratë gjendjen shëndetësore të tij. Subjekti potencon se vuan nga një sëmundje serioze autoimmune, [/***/] dhe nuk ishte në gjendje të përmbushte barrën e provës në afatin që kërkonte procedimi administrativ e, për pasojë, i janë shkelur disa të drejta themelore.
- ii) Sipas subjektit, Komisioni ka gabuar në vlerësimin profesional, pasi vonesat procedurale të shkaktuara prej tij gjatë ushtrimit të detyrës, janë pasojë e sëmundjes, e cila i ka ulur rendimentin në punë. Subjekti pretendon edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, në aspektin e gjësë së gjykuar, pasi ai është rikthyer në detyrë me një vendim të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Problemet shëndetësore ndikojnë në përballimin e mbingarkesës në punën si gjyqtar, gjë që ul performancën e tij në kontrollin material e procedural të çështjeve.

B. Parashtrimet e datës 16.06.2023

- 5. Me parashtrimet e datës 16.06.2023, depozituar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit përpara seancës së caktuar për shqyrtimin e ankimit, subjekti i rivlerësimit ka potencuar edhe që: (i) situata e tij shëndetësore ka pësuar përkeqësim në kohën e ndërmjetme nga dhënia e vendimit të Komisionit deri në shqyrtimin e ankimit, duke e vështirësuar lëvizjen e tij; (ii) nuk mund të gjykohej si i paaftë për punë në aspektin profesional, për shkaqe shëndetësore. Autoriteti

² Faqe 2959 e fashikullit nr. 9 të dosjes hetimore.

kompetent për të verifikuar aftësinë për punë, është Shkolla e Magjistraturës, e cila në vlerësimin e tij, nuk pranon gjyqtarë që vuajnë nga një sëmundje e tillë.

5.1. Konkretisht, subjekti kërkoi riçelje të hetimit gjyqësor për të verifikuar zotësinë e tij për të vepruar, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe parashtron se:

- i) I është cenuar aksesit në gjykatë, pasi për shkak të paaftësisë shëndetësore, nuk ka mundur të sigurojë provat në afatin e kërkuar.
- ii) Është diskriminuar padrejtësisht nga Komisioni, për shkak të aftësive të kufizuara.
- iii) Gjendet në kushtet e nenit 10 të Kodit Civil, pasi për shkak të sëmundjes është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, e që me vendim gjykate mund t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike.

5.2. Në përfundim, subjekti kërkon nga Kolegji:

- i) Prishjen e vendimit nr. 317, datë 20.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- ii) Kthimin e çështjes së rivlerësimit të tij për rihetim, për shkak të paaftësisë shëndetësore të magjistratit.
- iii) Orientimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për zgjidhjen e çështjes.

Në mënyrë alternative, kërkon që Kolegjit të vendosë:

- i) Ndryshimin e vendimit nr. 317, datë 20.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- ii) Zbatimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të pezullimit nga detyra, shoqëruar me detyrimin për të kaluar kontrollin mjekësor, sipas kërkesave të Shkollës së Magjistraturës, me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit, nëse subjekti arrin të provojë të kundërtën.

5.3. Në vijim të kërkimeve të sipërreferuara, nga ankimi dhe parashtrimet, rezulton se subjekti është fokusuar vetëm në prapësime të konkluzioneve të Komisionit, që lidhen me kontrollin e kriterit të pasurisë. Konkretisht, në ankim, përfaqësuesi ligjor parashtron se subjekti nuk ka deklaruar qartësisht dhe nuk ka mundësi që të deklarojë me dokumentacion të plotë mbështetës marrëdhënien e pronësisë me apartamentin me sipërfaqe 63 m², në Fier, pasi ai posedohet nga pronari i tij aktual, i cili paguan shërbimet utilitare. Pasaktësia në deklaram është rrjedhojë e mosgjendjes së pronarit të ri [z. Ç. K./K.]. Nga fatura për furnizim me ujë të pijshëm, provohet që apartamenti është i pabanuar.

5.4. Bashkë me parashtrimet, subjekti ka bashkëlidhur tre akte, për të cilat kërkoi të pranohen në cilësinë e provës së re, të cilat dhe datojnë pas ankimit, përkatësisht në prill 2021 dhe qershor 2023.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Aspektet procedurale të gjykimit

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

7. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të pikës 2, të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar në Komision brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

7.1. Në zbatim të parashikimeve të pikës 1, të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit gjyqësor, Kolegji zbaton një grup dispozitash të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar [në vijim “ligji nr. 49/2012”], përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të tij. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegji, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përrjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues gjen se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 317, datë 20.11.2020, të Komisionit, fillimisht u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi. Pasi analizoi aktet e sjella në ankim dhe në parashtrime nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim për këtë rast, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Arsyetimi i trupit gjykues shtjellohet në vijim.

7.2. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përmbajtje të ankimit, që ka të bëjë me rivlerësimin e provave të administruara nga Komisioni dhe administrimin e akteve bashkëlidhur ankimit³ dhe parashtrimeve⁴ në cilësinë e provave të reja⁵. Në thelb, nëpërmjet depozitimit të këtyre dokumenteve, subjekti synoi të provojë që nuk e ka në posedim apartamentin që Agjencia Shtetërore e Kadastrës Fier e ka pasqyruar në bashkëpronësi të tij me prindërit. Sa i takon shkakut të paraqitjes së këtyre akteve, pasi është marrë vendimi objekt ankimi, subjekti thekson pamundësinë e mëparshme për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

³Aktet e sjella me ankimin janë: (i) faturë tatimore tetor 2020 dhe dhjetor 2020, për kontratën e energjisë elektrike mes Ç. K. e B. Ç., për furnizimin me kontratë nga OShEE Grup, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FShU); (ii) faturë tatimore shitje uji nëntor 2020 UK Fier, datë 30.01.2020, për periudhën nëntor 2020; (iii) akte mbi familjen e blerësit që tregojnë se nuk ka regjistruar apartamentin me sipërfaqe 63 m², në Fier.

⁴ Aktet e sjella nga subjekti me parashtrimet janë: (i) një shkresë nga Ujësjellës Kanalizime Fier që mban datën 16.04.2021, për të dhënat e z. Ç. K.; (ii) kërkesën/aplikimin pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier, për kopje të kartelës së pasurisë; (iii) certifikatë familjare e subjektit.

⁵Në faturën e energjisë elektrike për muajt tetor-nëntor 2020, lëshuar për klientin Ç. K. dhe B. Ç., në këtë apartament, është aplikuar vetëm tarifë fikse shërbimi dhe nuk ka konsum. Në faturën e furnizimit për shpenzime të ujit të pijshëm, lëshuar klientit Ç. K., ka një tarifë shërbimi të papërfillshme, ndërsa konsumi është në masën 0 (zero) lekë. Po ashtu, për leximin e mëparshëm, konsumi është 0 (zero) lekë, tarifatat e tjera janë taksat të ndryshme dhe në total fatura është 752 lekë. Me fjalë të tjera, në këtë periudhë nuk ka pasur konsum të evidentuar.

7.3. Në vijim të sa më sipër, nga leximi harmonik i parashikimeve në nenet 47 dhe 49 të ligjit nr. 49/2012, për rastet kur mund të pranohen prova të reja në ankim dhe nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, për provat e sjella me parashtrimet, trupi gjykues i Kolegjit e kreu analizën për pranueshmërinë e këtyre akteve, nën dritën e rregullimeve ligjore që normojnë shkaqet për të cilat gjykata vendos kalimin në seancë gjyqësore në prani të palëve, përcaktuar nga germa “a”, e pikës 1, të nenit 51 të të njëjtit ligj⁶. Nga kjo analizë, rezulton se në procedurën e ndjekur në Komision nuk evidentohen elementë, të cilët lindin nevojën për debat gjyqësor me praninë e palëve, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 49/2012. Subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat procedurale, përfshirë njohjen me aktet e dosjes, dhënien e kohës së nevojshme për të paraqitur provat sipas rezultateve të hetimit dhe nuk rezulton që Komisioni të ketë penguar subjektin në paraqitjen e provave apo të ketë refuzuar marrjen e tyre. Përkundrazi, nga aktet rezulton që Komisioni ka pranuar të dy kërkesat e subjektit për kohë shtesë [për përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe për shpjegimet rreth rezultateve të hetimit], duke e shtyrë afatin e paraqitjes së tyre, si dhe ka marrë e shqyrtuar aktet e depozituara nga subjekti. Po ashtu, vendimi i Komisionit nuk përmban kundërthënie dhe nuk evidentohen elementë që të tregojnë qoftë edhe si indicie, nevojë për konstatim më të thelluar apo saktësim të gjendjes faktike.

7.4. Sa më sipër, e bën të panevojshme marrjen e provave të reja. Po ashtu, nga aktet në fashikull dhe shkaqet e ankimit të parashtruara nga subjekti, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi shkelje procedurale që do ta bënin të cenueshme procedurën e ndjekur nga Komisioni. Së fundmi, nën dritën e kërkesave të nenit 47⁷ të ligjit nr. 49/2012, që përcakton rrethanat përjashtimore në të cilat në ankim mund të paraqiten prova të reja, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe në konsideratë të pamundësisë së subjektit për t'i paraqitur ato për shkaqet e parashtruara prej tij, këto akte, gjithsesi, do të ishin pa efekt në zgjidhjen përfundimtare, duke u kategorizuar, si rrjedhojë në situatën e parashikuar nga neni 49, pika 6, gerrat “a” dhe “b”⁸ të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ndryshojnë faktin që apartamenti i ndodhur në Fier [shtjelluar në vijim në kriterin e kontrollit të pasurisë] është i regjistruar në emër të subjektit dhe prindërve të tij.

7.5. Në parashtrimet e datës 16.06.2023, të depozituara në Kolegj, sipas parashikimit të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, përpara seancës së caktuar për shqyrtimin e ankimit, subjekti ka kërkuar *riçeljen* e hetimit gjyqësor dhe verifikimin e *zotësisë për të vepruar* për shkak të sëmundjes. Trupi gjykues i Kolegjit theksohen se *riçelja* e hetimit gjyqësor kushtëzohet nga plotësimi i kriterëve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, referuar e analizuar edhe më sipër. Pa rënë në përsëritje, nga aktet në fashikull nuk rezulton gjendje faktike apo ligjore që passjell nevojën

⁶ Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon: “[...] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

⁷ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

⁸ Pika 6, e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, përcakton: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...]”.

për riçeljen e hetimit në kushtet që nuk konstatohen problematikat që do të passillnin zbatimin e kësaj dispozite. Aktet e dorëzuara me parashtrimet me shkrim, sikurse edhe ato që shoqërojnë ankimin, nuk u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues, nën dritën e analizës së dispozitave ligjore që gjejnë zbatim për rastin konkret. Pretendimet e tjera, të cilat lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe të drejtën e aksesit në gjykatë, kundrejtohen ndaj mënyrës së analizës së kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe të aftësive profesionale dhe janë trajtuar të detajuara në analizë të këtij vendimi.

B. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

8. *Pretendimet për cenim të procesit të rregullt ligjor, për shkak të mosdeklarimit të konfliktit të interesit me trupën gjykuese dhe ndikimit që mund të ketë pasur zëvendësimi i komisioneres*

8.1. Subjekti i rivlerësimit ngre këtë pretendim bazuar në faktin që një ndër komisionerët, znj. Alma Faskaj, është zëvendësuar me komisioneren Etleda Çiftja më datë 05.10.2020, për shkaqe shëndetësore. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim, rezulton që ai është njoftuar për ndryshimin e trupës gjyqësore dhe shkaqet e këtij ndryshimi nëpërmjet postës elektronike të datës 05.10.2020. Për këtë njoftim, subjekti nuk ka kthyer përgjigje. Nga aktet në fashikull rezulton se më herët, më 15.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me asnjërin prej anëtarëve të trupës gjykuese të përbërë nga znj. Alma Faskaj dhe z. Lulzim Hamitaj dhe relatores znj. Genta Tafa Bungo. Njoftimi i këtij zëvendësimi është bërë brenda afateve ligjore dhe nga fashikulli nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur ndonjë rezervë. Edhe komisionerja zëvendësuese ka shprehur mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Zëvendësimi i znj. Faskaj rezulton të ketë ndodhur edhe për subjekte në çështje të tjera. Së fundmi, edhe në seancën dëgjimore, pasi është njohur me trupën gjykuese të Komisionit, subjekti nuk ka shprehur asnjë kundërshtim apo parashtruar ndonjë situatë që mund të përbëjë cenim të procesit të rregullt ligjor, qoftë edhe nëse shihet në kontekstin e parashtruar prej tij, për shkak të moskërkimit prej tij të përjashtimit të një apo disa komisionerëve.

8.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim rezulton të jetë ngritur për herë të parë në ankimin e vendimit. Nga aktet në fashikull, në këndvështrimin kronologjik, rezulton se në harkun kohor nga nisja e procesit të rivlerësimit të subjektit, deri në datën e njoftimit të ndryshimit të anëtares së trupit gjykues [znj. Faskaj], janë kryer veprime hetimore, që përfshinin mbledhjen e provave dhe përgatitjen e dosjes për shqyrtim, sipas parashikimeve ligjore e nënligjore⁹. Pretendimi i subjektit për ndikimin negativ që ka pasur në këtë çështje zëvendësimi i një prej anëtareve të trupit gjykues, rezulton i pabazuar në dispozitat që rregullojnë procesin e rregullt, sikurse edhe parë në kontekstin e rrethanave faktike, analizuar edhe në drejtim të kriterëve *objektive* e *subjektive* të shtjelluara e konsoliduara në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”)¹⁰. Në kushtet që subjekti nuk ka parashtruar rrethana për mungesë paanësie të anëtares zëvendësuese, pretendimi i tij, se prania e një komisionereje kundrejt një tjetre përbën cenim të procesit të rregullt në rivlerësimin e kryer për të është, jo vetëm i pabazuar, por edhe i pakuptimtë. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë argument sesi dhe mbi çfarë baze, zëvendësimi i një anëtareje të trupës, nëntë (9) muaj pasi ajo ka bërë me dije

⁹ Neni 14 i ligjit nr. 84/2016 dhe Rregullorja e Komisionit <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/12/Hapat-Procedurale-te-Unifikuar-2-1.pdf>.

¹⁰ Referuar, ndër të tjera, në *Kyprianou kundër Qipros [GC]*, 2005, § 119 dhe *Hauschildt kundër Danimarkës D1989*, § 47.

pamundësinë e të qenit në detyrë për një periudhë të caktuar kohore apo në 10 ditët e ndërmjetme mes njoftimit të marrë prej subjektit për zëvendësimin dhe marrjes së rezultateve të hetimit, ka cenuar të drejtat e tij për proces të rregullt. Për sa më sipër, në kushtet që subjekti nuk ka pretenduar ekzistencën e konfliktit të interesit me komisioneren Çiftja dhe as ka parashtruar në ndonjë formë gjatë procesit apo edhe në ankim rrethana të cilat edhe teorikisht mund të përbënin mungesë paanësie apo për të cilat ajo kishte pengesë ligjore nën dritën e nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative [ligji nr. 44/2015], ky pretendim rezulton i pambështetur edhe në analizën fundore e gjithëpërfshirëse të rrethanave konkrete.

8.3. Përkundër pretendimit të subjektit se fakti që ai nuk ka shprehur pëlqimin për zëvendësimin e bën procesin e hetimit në Komision të padrejtë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për të arritur në një konkluzion përfundimtar, dispozitat ligjore që normojnë krijimin e trupave gjyquese, në ligjin nr. 84/2016 dhe në Kodin e Procedurave Administrative, nuk parashikojnë pëlqimin apo dakordësinë e palës për zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues, si kriter për zhvillimin e gjykimit. Palët/subjekti i rivlerësimit marrin dijeni për zëvendësimin apo ndryshimin e trupës gjyquese, kur është rasti, dhe duhet të shprehin pasjen ose jo të konfliktit të interesit. Për më tepër, në rastin konkret, zëvendësimi ka qenë i paevitueshëm duke u diktuar nga shkaqe shëndetësore. Sidoqoftë, në zbatim të pikës 3, të nenit 31 të Kodit të Procedurave Administrative¹¹, nëse subjekti konstatonte ekzistencën e pengesave ligjore të pjesëmarrjes në procedurën administrative për një komisioner, përpara marrjes së vendimit, do të duhet të kishte paraqitur kërkesë me shkrim, së bashku me provat përkatëse. Nga aktet në fashikull rezulton që, edhe pasi Komisioni i ka kërkuar subjektit deklarin e konfliktit të interesit me komisioneren zëvendësuese, ai nuk ka deklaruar në këtë drejtim. Për rrjedhojë, në kushtet që subjekti apo përfaqësuesi i tij ligjor nuk kanë paraqitur kërkesë për përjashtimin e ndonjërit nga anëtarët e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që pretendimi në nivel teorik, i pambështetur në prova, sikurse edhe i paraqitur pas vendimmarrjes së Komisionit, vjen në kundërshtim me nenin 30 të Kodit të Procedurës Administrative.

9. Pretendimi për mohim të së drejtës së subjektit dhe përfaqësuesit ligjor për t'u njohur me dosjen

9.1. Subjekti argumenton se procesi i kryer gjatë hetimit administrativ është në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, pasi nuk u pranua kërkesa e paraqitur në seancën dëgjimore për njohjen me aktet. Nga verifikimi i procedurës së ndjekur në Komision, nën dritën e dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative, rezultoi se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Nga këto akte, rezulton se subjekti me e-mail-in e datës 18.02.2020, ka kthyer përgjigjet e pyetësorit nr. 1, duke bashkëngjitur edhe provat dhe me e-mail-in e datës 28.05.2020, i është dërguar për plotësim pyetësori i dytë, duke iu lënë 10 ditë afat. Për plotësimin e këtij pyetësori, subjekti ka paraqitur kërkesë për kohë *shtesë* dhe Komisioni ka shtyrë afatin me një javë, deri më datë 15.06.2020. Subjekti ka kthyer përgjigje më datë 14.06.2020 dhe ka bashkëngjitur provat. Me vendimin nr. 2, datë 15.10.2020, Komisioni ka vendosur që të përfundojë hetimin administrativ, të njoftojë subjektin për t'u njohur me rezultatet e hetimit dhe me provat e administruara, t'i kalojë barrën e provës, i ka kërkuar deklarin e konfliktit të

¹¹ “[3.] Pala mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtarit të organit kolegjial nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet eprorit dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet [...]”.

interesit, si dhe të drejtën e paraqitjes së provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht. Subjekti është njoftuar për këtë vendim më datë 15.10.2020.

9.2. Pas rezultateve të hetimit, me *e-mail*-in e datës 20.10.2020, subjekti ka deklaruar *njohjen* me dokumentet e dosjes dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të paraqitjes së provave për shkak të gjendjes shëndetësore. Komisioni e ka pranuar kërkesën duke shtyrë afatin me gjashtë (6) ditë. Më datë 02.11.2020, subjekti me katër komunikime elektronike (4 *e-mail*) ka dërguar kopje të provave të tij dhe dy raporte të paaftësisë së përkohshme në punë. Pas njohjes me raportet e përkohshme të paaftësisë në punë, Komisioni ka caktuar datën e seancës dëgjimore duke marrë në konsideratë mundësinë e rikthimit të subjektit në punë pas përfundimit të afatit të raportit. Subjekti nuk ka paraqitur kundërshtime për datën e re të caktuar.

9.3. Gjatë seancës dëgjimore, vetëm pasi kryesuesi i trupës gjykuese ka sjellë në vëmendje që subjekti nuk ka përdorur të drejtën të njihet me dosjen, ndonëse është njoftuar për këtë qëllim, përfaqësuesi ligjor i subjektit ka kërkuar ta ushtrojë këtë të drejtë¹². Komisioni ka informuar që njohja me aktet nuk mund të kryhet në këtë fazë dhe ka vijuar me seancën dëgjimore. Subjekti apo përfaqësuesi ligjor nuk rezultojnë të kenë paraqitur pretendime se kjo i krijonte pengesë në ushtrimin e të drejtave apo të kenë argumentuar përse njohja me aktet, pavarësisht nga njoftimi, ishte e pamundur në një moment të mëparshëm. Përkundrazi, këto pretendime subjekti i ka ngritur për herë të parë në ankim. Përpos këtij fakti, këto pretendime janë kontradiktore në kushtet që subjekti ka konfirmuar dijeninë e akteve të dosjes¹³, ndërsa përfaqësuesi i tij ligjor në seancë ka paraqitur nevojën për t'u njohur me to. Në përmbledhje e si konkluzion i sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti, duke e deklaruar njohjen me aktet dhe mosushtrimin e të drejtës së njohjes me dosjen brenda afatit të caktuar pa shkaqe të arsyeshme, e bën të pabazuar pretendimin se i është mohuar kjo e drejtë. Në të njëjtën linjë konstatimi, trupi gjykues vëren se pretendimi se iu mohua e drejta e përfaqësuesit për t'u njohur me aktet në seancë dhe e drejta për t'u përfaqësuar me përfaqësues ligjor është i pakuptimtë, pasi bie ndesh qartë me prezencën e avokatit në seancë dhe kërkimet e parashtruara prej tij. Kolegji konstaton se përfaqësuesi ligjor është legjitimuar nga Komisioni dhe nuk rezultojnë pengesa të ilustruara me fakte sa i takon ushtrimin të përfaqësimit.

10. *Pretendimet lidhur me ushtrimin në mënyrë efektive të mbrojtjes, si dhe përmbushjes së barrës së provës*

10.1 Subjekti ka pretenduar pamundësi të përmbushjes së barrës së provës dhe të mbrojtjes efektive në drejtim të ushtrimit të këtyre të drejtave për shkak të sëmundjes. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi procedurën e ndjekur nga Komisioni nën dritën e neneve 6 dhe 14 të KEDNj-së dhe jurisprudencës së GjEDNj-së dhe konstatoi se edhe ky pretendim nuk paraqitet i bazuar në prova. Nga aktet në fashikull, rezulton se Komisioni ka komunikuar rregullisht e në mënyrë të vazhdueshme duke e njoftuar subjektin për mundësinë e njohjes me aktet e dosjes, për të paraqitur shpjegime për faktet, rrethana apo çështje të tjera, si dhe të depozitojë prova, sipas neneve 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, analizuar në paragrafin e mësipërm. Komisioni, po ashtu, ka pranuar kërkesat për zgjatje të afatit duke i lënë subjektit edhe kohë shtesë [përkatësisht gjashtë dhe shtatë ditë]. Subjekti rezulton të ketë marrë pjesë në këtë proces

¹² Avokat Y. K., sipas procesverbalit të seancës dëgjimore pjesë e fashikullit.

¹³ Në datën 22.10.2020, sipas akteve në fashikull (si në paragrafin 9.2).

dhe të ketë shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes, duke paraqitur provat dhe shpjegimet, të cilat i ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësorëve përkatës gjatë hetimit administrativ. Së fundmi, nuk rezulton që subjekti të ketë kërkuar në Komision të administrohen prova të tjera apo t'i ketë paraqitur ato vetë.

10.2 Nga aktet rezulton se subjekti ka caktuar përfaqësues ligjor, për të kryer çdo veprim përfaqësues pranë gjykatave dhe mbledhje provash në institucione, në emër të tij në vitin 2017. Për rrjedhojë, subjekti ka pasur mundësinë që të kryente një mbrojtje efektive, sipas kërkesave dhe pritshmërisë së tij, që në fillim të procesit të rivlerësimit kalimtar. Duke mbajtur parasysh që koncepti i kalimit të barrës së provës edhe në kontekstin e procesit të rivlerësimit është garantimi i ushtrimit të të drejtave për një proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe të drejtën për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi, në kuadër të parimit të kontradiktorialitetit dhe atë të barazisë së armeve. Nga analiza e shtjelluar më sipër, bazuar në aktet në fashikull, subjekti rezulton të ketë ushtruar të drejtat, për këto aspekte të procesit të rregullt, lirisht. Pa përsëritur sa është konstatuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstatoi asnjë indicie veprimesh të ndërmarra gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, të cilat mund të argumentoheshin të kontestueshme në drejtim të procesit të rregullt. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë pretenduar shkelje procedurale në lidhje me kalimin e barrës së provës. Në këto kushte, trupi gjykues konkludon se ky pretendim është i pabazuar. Subjekti nuk ka ushtruar të drejtën e garantuar e potencuar në korrespondencë nga Komisioni për njohje me dosjen sipas afatit të përcaktuar [deri në seancën dëgjimore]. Njëkohësisht, subjekti duke u shprehur për njohje me dosjen që në e-mail-in e datës 20.10.2020, ky detyrim procedural vlerësohet i ezauruar rregullisht nga Komisioni. Së fundmi, në kushtet që trupi gjykues i Kolegjit nuk konstatoi diskriminim, pengim në ushtrimin e mbrojtjes efektive apo cenim të aksesit në gjykatë të subjektit, pretendimet me natyrë procedurale vlerësohen të pabazuara.

C. Kriteri i vlerësimit të pasurisë

11. *Arsyetimi i pretendimit që lidhet me moszbatimin e kushteve për masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, meqenëse nuk ka në pronësi më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme*

11.1 Vendimi i Komisionit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është marrë [ndër të tjera], pasi ai është gjetur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e njëjës prej pasurive në pronësi të tij, parashikuar nga germa “b”, e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka arritur të provojë mundësinë financiare të së motrës për dhënien e huas, në mënyrë që të justifikojë vlerën e blerjes së apartamentit të banimit. Ky konkluzion, analizuar gjerësisht në vijim të këtij arsyetimi, ka passjellë zbatimin e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që është i ndryshëm nga shkarkimi sipas pikës 1 të të njëjtës dispozitë – situata e dyfishit të pasurisë së ligjshme.

11.2 Masa disiplinore për shkarkimin nga detyra, që ka vendosur Komisioni për subjektin e rivlerësimit, është konkluzion i njëjës prej pesë (5) situatave ligjore të parashikuara në mënyrë individuale në këtë nen. Secila pikë e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe e nenit 61 e po këtij ligji, është autonome, ka të njëjtën peshë dhe përbën në vetvete shkak për *shkarkim nga detyra*. Këtyre situatave ligjore u korrespondojnë dispozita të ndryshme të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë dhe duke lexuar në mënyrë harmonike gjithë kuadrin kushtetues e ligjor që përcakton kushtet të cilat passjellin shkarkimin nga detyra, rezulton se subjektet që nuk gjenden në kushtet e dyfishit

të pasurisë së ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duhet të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave, për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për sa shtjelluar në këtë paragraf, nën dritën e nenit D¹⁴ të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61¹⁵ të ligjit nr. 84/2016, zberthyer gjerësisht nga jurisprudenca e Kolegjit në vendimet e tij¹⁶, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

12. *Arsyetimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit lidhur me apartamentin e ndodhur në Tiranë*¹⁷

12.1. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nuk ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për këtë pasuri në vlerën prej 3.354.368 lekësh. Të ardhurat e motrës së subjektit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur/huadhënëses, nuk justifikojnë huan për blerjen e apartamentit. Komisioni ka kryer hetim administrativ, për sa i përket të ardhurave të mundshme të motrës në cilësinë e huadhënëses, përfshirë edhe nga aktiviteti tregtar i familjarëve të saj. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar riçeljen e hetimit dhe administrimin e ekstraktit të aktivitetit të shoqërisë tregtare të bashkëshortit të motrës dhe të atit të tij, për të provuar mundësinë financiare të saj për të dhënë huan. Ndër aktet e sjella prej subjektit bashkëlidhur ankimit, asnjëri nuk lidhet me këtë aktivitet tregtar.

12.2. Nga analiza e akteve në fashikull, kundrejt shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i drejtë dhe hetimi i kryer ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm. Po ashtu, kërkesa e subjektit për riçelje të hetimit gjyqësor është e pabazuar. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova apo fakte të reja, të cilat do të ndikonin në vendimmarrje e të cilat nuk ka mundur t’i parashtrojë më parë për shkaqe që nuk varen prej tij dhe as nuk gjendej në pamundësi objektive, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, riçelja e hetimit nuk përmbush kriteret përcaktuese të neneve 47 e 51 të ligjit nr. 49/2012. Në vijim shtjellohet arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion.

12.3. Nga aktet në fashikull rezulton *së pari*, se, sikurse ka konstatuar Komisioni, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kundërshtim me përcaktimet e germës “a”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2005, subjekti ka deklaruar huan në vlerën 30.000 euro në rubrikën e detyrimeve

¹⁴ Neni D - 1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...] 4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën. [...].

¹⁵ Neni 61 i ligjit nr. 84/2016, parashikon: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të. [...] 3. Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji. 4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. 5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemit të drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”.

¹⁶ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 32, datë 28.07.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Balliu (parag. 21).

¹⁷ Me sipërfaqe 86,5 m², blerë në vlerën 30.000 euro më 28.04.2006.

financiare, marrë për banesë me kontratë noteriale huaje¹⁸. Ndër vite, në harkun kohor 2005-2011, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kësaj huaje. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe 2, subjekti deklaroi se burimi i krijimit të apartamentit, është huaja në vlerën 30.000 euro, e marrë nga familja e motrës, me të ardhurat nga aktiviteti privat i tyre, dhënë në formë ndihme dhe dashamirësie. Më tej, subjekti deklaroi se vlera nuk disponohej nga motra vetë, pasi janë të ardhura të mundësuar nga familja e bashkëshortit të saj, të përfituara nga emigracioni dhe aktiviteti privat i ushtruar për disa vjet, të cilin e administronte vjehri i ndjerë i motrës.

12.4. Së dyti, nga aktet rezultojnë, po ashtu, se gjatë hetimit administrativ, Drejtoria e Tatimeve Tiranë¹⁹ ka informuar Komisionin se kunati i subjektit [bashkëshorti i motrës] ka regjistruar biznesin e tij në vitin 2014, që nënkupton një moment në kohë tetë (8) vite pasi subjekti ka blerë apartamentin. Motra e subjektit, znj. E. Gj., nuk ka biznes të regjistruar. Në funksion të hetimit, për gjendjen financiare të huadhënësës në vitin 2005, Komisioni ka administruar vendimin nr. (s'ka), datë 29.06.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga i cili rezultojnë se në vitin 1993 kunati [z. A. Gj.] është regjistruar si person juridik me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit privat në fushën e tregtisë dhe transportit. Nga ana tjetër, Qendra Kombëtare e Biznesit²⁰ ka konfirmuar regjistrimin e këtij personi juridik, por ka konstatuar mungesë numri reference [NUIS/NIPT]. Nga e njëjta shkresë rezultojnë se nuk ka akt çregjistrimi të aktivitetit. Nga shkresa e Drejtorisë së Tatimeve nuk kanë rezultuar të dhëna për këtë person juridik. Më 26.01.2005, kunati i subjektit është regjistruar si person fizik, me objekt veprimtarie “Bilardo”, të cilën e ka çregjistruar gjashtë (6) muaj më pas, më datë 14.07.2005. Edhe për këtë aktivitet nuk ka të dhëna financiare nga tatimet²¹.

12.4.1. Subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion që provon se motra e bashkëshortit i saj kishin ekonomi të përbashkët familjare me prindërit e këtij të fundit, në mbështetje të pretendimit të tij, që të ardhurat kishin prejardhje nga aktiviteti privat familjar, përfshirë edhe atë të vjehrit të motrës. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ILDKPKI-ja²², në certifikatën e regjistrimit në organin tatimor pranë Ministrisë së Financave, shoqëria tregtare²³, ku përfaqësues ka qenë vjehri i motrës së subjektit, e cila rezultojnë e regjistruar me vendim nr. {***}, datë 27.03.1995 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, ka pasur afat veprimtarie 10 vjet. Veprimtaria, sipas akteve, ka filluar nga data 06.04.2000. Komisioni ka administruar një kontratë të vitit 2001²⁴, nga e cila rezultojnë që kunati i subjektit i ka dhuruar një automjet shoqërisë së sipërcituar. Nga ana tjetër, ky dhurim duket e vetmja lidhje ligjore mes kunatit të subjektit dhe shoqërisë [“{***}” ShPK], që përfaqësohej nga i ati/vjehri i motrës. Edhe nga të dhënat bankare të administruara, kunati i subjektit nuk rezultojnë të ketë përfituar të ardhura nga shoqëria që të mund të analizoheshin në drejtim të mundësisë së kontributit nëpërmjet vlerës së huas. Së fundmi, nga fashikujt, sipas akteve të përcjella nga Drejtoria e Tatimeve, nuk ka rezultuar që bashkëshorti i motrës së subjektit të ketë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj vlere.

¹⁸ Subjekti ka referuar edhe numrin e kontratës noteriale të huas, nr. {***}, datë 04.07.2005, hartuar në prani të noteres M. V..

¹⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.06.2020.

²⁰ Nr. {***} prot., datë 06.03.2020, “Kthim përgjigje”, drejtuar Komisionit.

²¹ Të dhënat e siguruara nga shkresa nr. {***} prot., datë 06.03.2020, kthim përgjigje, e QKB-së.

²² Dokumentet që subjekti i rivlerësimi ka dërguar në ILDKPKI më datë 23.03.2015.

²³ “{***}” sh.p.k., me objekt kryesor të veprimtarisë: “Punim [...] mermeri”.

²⁴ Dërguar nga ILDKPKI-ja.

12.5. Në përmbledhje të sa më sipër, edhe në analizën e kryer në Kolegj në funksion të shkaqeve të ankimit, e nën dritën e përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, rezultoi që subjekti nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme që do të mundësonin dhënien e huas nga motra e tij në vitin 2005, sikurse edhe ka bërë deklaram të pasaktë për shkak të mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurisë në deklaratën *vetting*, përcaktuar në geramat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

13. Arsyetimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit lidhur me apartamentin e ndodhur në Fier²⁵

13.1. Komisioni konkludoi se subjekti nuk ka deklaruar qartësisht dhe me dokumentacion mbështetës marrëdhënien e pronësisë për këtë pasuri, duke e vënë [atë] sërish në pozitën e deklarimit të *pamjaftueshëm*. Në ankim, subjekti pretendoi se kjo pronë është shitur në vitin 1995, pranë noteres N. B., por kontrata e shitjes nuk mund të gjendet, pavarësisht kërkimeve të tij. Gjithashtu, subjekti kërkoi të administrohen në cilësinë e provave dy fatura të lëshuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim “OShEE”) Fier dhe Ujësjiellës Kanalizime (në vijim “UK”) Fier. Faturat janë të muajve tetor dhe nëntor 2020. Nëpërmjet tyre, ankuesi pretendon se vërtetohet *braktisja* e pronës. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i bazuar, ndërsa subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm e të provojë me dokumentacion shkaqet e mosdeklarimit të kësaj prone, në kushtet që ajo rezulton të jetë ende në emër të tij dhe të personave të lidhur, referuar akteve në fashikull²⁶. Arsyetimi, mbi të cilin bazohet ky konkluzion, shtjellohet në vijim.

13.2 Nga kontrolli i akteve të administruara në dosje, rezulton se apartamenti është fituar nga familja e subjektit nëpërmjet privatizimit²⁷ dhe është regjistruar më datë 20.11.2000, pranë Zyrës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier (në vijim “AShK”), në bashkëpronësi të subjektit me prindërit e tij. Subjekti nuk e ka deklaruar atë në deklaratat periodike vjetore ndër vite, as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Ndërsa, nga përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar që kjo pasuri është shitur ndërmjet viteve 1995-1997 dhe nuk disponon kontratën noteriale të kalimit të pronësisë. Subjekti, po ashtu, pretendoi se detyrimin e regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë pranë AShK-së e ka blerësi.

13.3 Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndonëse shpjegimi i sipërreferuar i subjektit është i saktë, nën dritën e nenit 11²⁸ të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i shfuqizuar, në fuqi në kohën kur pretendohet se është kryer shitja/kalimi i pronësisë, nga aktet rezulton se regjistrimi i kësaj pasurie, në bazë të të njëjtit ligj [nenit 10] në *bashkëpronësi të subjektit* të rivlerësimit me prindërit, është bërë më datë 20.11.2000, disa vite pasi pretendohet të ketë ndodhur shitja. Me fjalë të tjera, ndonëse subjekti saktësisht ka potencuar se regjistrimi kryhet nga blerësi, fakti që apartamenti në vitin 2000 është regjistruar në emër të *subjektit dhe prindërve* tregon që dokumentacioni i pronësisë në emër të tyre ka qenë i përshtatshëm për të kryer regjistrimin në AShK në vitin 2000. Kjo nënkupton nga ana tjetër, që në thelb pretendimet e subjektit, për shitjen në harkun kohor 1995-1997, janë të pabazuara në dokumentacion.

²⁵ Me sipërfaqe 63,6 m², në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me prindërit e tij.

²⁶ Referuar shkresës, me nr. {***} prot., datë 21.05.2020, kthim përgjigje, të AShK-së Fier.

²⁷ Sipas ligjit nr. 7652/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

²⁸ Çdo kontratë apo dokument tjetër që ka efekt mbi të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme paraqiten për regjistrim jo më vonë se tridhjetë ditë nga koha e realizimit të tij.

13.4. Në vlerësimin e këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konstatimi i Komisionit është i drejtë. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në asnjë prej deklaratave periodike vjetore, sikurse edhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, nën dritën e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës²⁹, të nenit 30³⁰ të ligjit nr. 84/2016, si dhe atyre të nenit 4³¹ të ligjit nr. 9049/2003. Pretendimet e tij në procesin e hetimit administrativ dhe në ankim se pasuria ishte tjetërsuar në vitet 90' bien ndesh me sa rezulton nga dokumentacioni ligjor, sipas së cilit apartamenti, jo vetëm është regjistruar në aktet zyrtare në emër të tij e familjarëve, por edhe ka vijuar të jetë në të njëjtin status gjatë procesit të zhvilluar në Komision. Nga ana tjetër, subjekti nuk arriti të japë shpjegime bindëse për mospërputhjen mes rrethanave faktike të deklaruara prej tij – apartamenti i është shitur një individ tjetër dhe braktisur prej tij – me dokumentacionin ligjor. Të vetmet akte me vlerë provuese të administruara në fashikull, provojnë vijimin e marrëdhënies së pronësisë mes familjes subjektit ndër vite³². Nga ana tjetër, rrethanat e referuara mbetën në nivel deklarativ, në kushtet që subjekti nuk provoi qoftë edhe indirekt shitjen e apartamentit apo veprime të tjera, të cilat janë konsistente me tjetërsimin dhe humbjen e të drejtave të pronësisë.

13.5. Subjekti ka kërkuar që dy faturat e lëshuara nga UK-ja Fier dhe OSHEE-ja Fier të merren në cilësinë e provës së re në gjykim, në drejtim të argumentimit se familja e tij nuk banon në këtë apartament. Duke abstraguar nga fakti që këto akte përbëjnë provë të re në ankim dhe nuk përmbushin kriteret e nenit 47 të ligjit, në kushtet që subjekti kishte mundësinë t'i paraqiste në Komision, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti ato edhe pa efekt në vendimmarrje, situatë e parashikuar nga neni 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi, gjithsesi, mbetet i pakontestueshëm fakti që subjekti nuk ka deklaruar marrëdhënien e vazhdueshme të pronësisë ndër vite në deklaratën e pasurisë *vetting*. Pretendimet e subjektit për shitjen e pronës, ndërsa ai ishte student apo për pamundësinë për të gjetur aktet pranë noteres, që *mund të ketë*³³ hartuar aktin e shitjes, pasi ajo nuk jeton në Fier, apo që e bija nuk disponon rreth arkivës, mbetën deklarative dhe të pabazuara në ligj. Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë” ka përcaktime të shprehura për kalimin e arkivit të zyrës noteriale të mbyllur³⁴ – siç është rasti i sjellë në vëmendje nga subjekti – një zyre tjetër noteriale. Ky ligj rregullon kalimin e arkivës së zyrës një noteri tjetër, sikurse edhe mënyrën e ruajtjes e dokumentimit të arkivës, në rast se noteri ndërron jetë gjatë ushtrimit të detyrës apo del në pension. Subjekti nuk arriti të shpjegojë mungesën e veprimeve nga ana e tij për të dokumentuar shitjen e apartamentit, nën dritën e rregulimeve të ligjit të zbatueshëm që

²⁹ Neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...] 3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj. [...]”.

³⁰ Neni 30 parashikon: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.”

³¹ Në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, në seksionin që i dedikohet deklarimit të interesave privatë, kërkohet nga deklaruesit të përshkruajnë hollësisht: “[...] burimet e origjinës apo të krijimit të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë”.

³² Shkresa e ASHK Fier [nr. prot.***], datë 21.05.2020, sikurse edhe kartela e pasurisë bashkëlidhur me ekstraktin nga volumi ***, faqe ***, dërguar Komisionit.

³³ Përfaqësuesi ligjor i subjektit është shprehur në mënyrë të tillë në seancën dëgjimore në Komision.

³⁴ Neni 67, pika 1 e ligjit nr. 11/2018 “Për noterinë”.

garantojnë, në nivel teorik së paku, ruajtjen e dokumentacionit arkivor të zyrës noteriale pavarësisht edhe pasi ndërpritet ushtrimi i detyrës së noteres.

13.6. Në të njëjtën mënyrë, Kolegji analizon edhe pretendimet në parashtrime, në të cilat subjekti shprehet se pasaktësia e deklarimit është pasojë e pamundësisë së tij për të kontaktuar pronarët/poseduesit aktualë të këtij apartamenti. Pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se vendosja e kontaktit me përdoruesit do të kishte peshë në rrethanat hipotetike, në të cilat, si shembull, mungonte dokumentacioni nga institucionet publike, që konfirmojnë bashkëpronësinë e subjektit apo në rrethana të tjera kur mungonin prova shkresore. Nga ana tjetër, përpjekja për të kontaktuar përdoruesit aktualë paraqitet relativisht e pakuptimtë nëse mbahet në konsideratë mungesa e përpjekjes së subjektit për të kërkuar kontratën e shitjes në arkivat e zyrës noteriale apo përpjekje të kryera prej tij për të hedhur dritë mbi sa rezulton nga kartela e pasurisë, përkundër sa pretendohet prej tij për tjetërsimin. Ndonëse me rëndësi dytësore në këtë analizë, trupi gjykues i Kolegjit i analizoi këto kontradikta në argumentet e subjektit si pjesë të analizës në tërësi të rrethanave që rezultojnë nga aktet dhe nga pretendimet e subjektit, në drejtim të besueshmërisë së versionit të fakteve të prezantuar prej tij. Ndonëse nuk përjashtohet mundësia që banesa të mos jetë në përdorim të subjektit e familjes së tij në momentin e hartimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti nuk shpjegoi në mënyrë bindëse tjetërsimin apo rrethanat, si pasojë e të cilave ai dhe familja kanë humbur të drejtat reale mbi këtë pasuri apo kohën kur kjo ka ndodhur. Pretendimi për *braktisje* të pronës nuk arrin të zhbëjë faktin që subjekti nuk ka deklaruar një pronë që ka qenë e regjistruar në emër të tij dhe të prindërve, sikurse edhe nuk ka ndërmarrë hapa për të qartësuar marrëdhënien e tij me të.

13.7. Në përmbledhje të sa më lart, pas kontrollit të dokumentacionit të dosjes përcjellë nga Komisioni, Kolegji arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dështoi të shpjegojë mosdeklarimin e kësaj prone në bashkëpronësi të tij dhe prindërve edhe gjatë procesit të rivlerësimit, fakt që rezulton nga dokumentacioni përcjellë nga AShK-ja në Komision. Në këto kushte, dhe në mungesë të dokumentacionit që provon pretendimin e subjektit për shitjen e pasurisë, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, nën dritën e përcaktimit të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

14. Analiza e shpenzimeve spitalore të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit [nënës së tij]

14.1 Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ shpenzime mjekësore për nënën në vitin 2014, kundrejt shumës 9.930 euro, mbuluar nga e motra. Komisioni konkludoi se në kushtet që subjekti nuk provoi të ardhurat e ligjshme të mjaftueshme të së motrës, për të mundësuar këtë shpenzim, nëna e subjektit – në cilësinë e personit të lidhur – nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shërbimet mjekësore, duke e vendosur subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

14.2 Nëpërmjet ankimit, subjekti ka potencuar marrëdhënien familjare në kuadër të së cilës janë kryer këto shpenzime dhe kërkoi: (i) riçeljen e hetimit dhe administrimin e ekstraktit historik të aktivitetit privat të bashkëshortit të së motrës – shoqërisë “{***}” ShPK. Subjekti argumenton se shpenzimi është mbuluar me të ardhura të ligjshme të aktivitetit të kësaj shoqërie.

Njëkohësisht, kërkoi edhe; (ii) të konstatohet se paaftësia e tij, për të vërtetuar ligjshmërinë e burimit në Komision, ka ardhur si pasojë e sëmundjes.

14.3 Në analizë të akteve në fashikujt e krijuar në Komision, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se pretendimet e subjektit janë të bazuara. Në vijim shtjellohet arsyetimi i trupit gjykues.

14.4 Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se e ëma ka marrë shërbim spitalor, në vlerën 9.930 euro, paguar nga motra e tij, znj. E. B.. Komision ka administruar mandatarkëtimin datë 03.02.2014, lëshuar nga Spitali {***}, Tiranë nënshkruar nga e motra, i depozituar nga subjekti. Ky akt mban gjeneralitetet dhe nënshkrimin e motrës dhe atë të arkëtarit të spitalit. Subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale të lëshuar nga e motra e tij [në vitin 2020], që konfirmon sa pretendon subjekti. Deklaruesja shprehet se ky shpenzim është mbuluar me të ardhura nga kursimet familjare të krijuara nga aktiviteti i shoqërisë “{***}” ShPK. Aktet e administruara nga Komisioni, nëpërmjet korrespondencës me institucionin shëndetësor, janë në përputhje me sa ka përcjellë subjekti.

14.5 Për sa më sipër, aktet në fashikull mbështesin shpjegimet e subjektit, ndërsa Komisioni nuk rezulton t'i ketë dhënë vlerën e duhur provuese. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se gjithë aktet e administruara, përfshirë edhe ato të mbledhura nga Komisioni kryesisht, mbështesin pretendimin e subjektit. Mandatarkëtimi administruar në fashikull plotëson elementet e vlefshmërisë³⁵, pasi ka të shtypur numrin, vlerën e paguar, datën, si dhe nënshkrimin e pageses dhe arkëtarit të spitalit. Me fjalë të tjera, mandatarkëtimi i plotëson elementet e formës dhe ka vlerë të plotë provuese. Edhe nga verifikimi i statement-it bankar të subjektit, nuk rezulton që të jetë bërë tërheqje me vlerë të përafërt rreth kësaj periudhe. Në këto kushte, mungojnë indiciet formale që kjo pagesë të jetë kryer nga subjekti.

14.6 Pavarësisht se në kontekstin e rivlerësimit nëna e subjektit është person i lidhur me të [subjektin], në kushtet që shpenzimet janë paguar nga një prej fëmijëve të tjerë të saj, zbatimi i detyrimeve për subjektin, parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në rrethanat konkrete, do të ishte disproporcionale, përpos e pabazuar në logjikën e gjerë të dinamikës së marrëdhënies prind-fëmijë. Konkretisht, përpos faktit që aktet tregojnë se pagesa është kryer nga motra e subjektit, trupi gjykues mban në konsideratë marrëdhënien familjare në analizë, si pasojë e së cilës një nevojë themelore si kujdesi shëndetësor, në marrëdhënien prind-fëmijë logjikshëm është i ndërsjellët dhe prek të paslindurit në raport të barabartë.

14.7 Ndërsa sa i përket kërkesës së subjektit për të administruar ekstraktin e shoqërisë “{***}” ShPK, Kolegji konstaton se Komisioni ka hetuar rreth mundësisë financiare të motrës së subjektit, duke administruar akte nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për aktivitetin, sikurse edhe

³⁵ Sipas nenit 9 të ligjit nr. 7661/1993, “Për kontabilitetin”, i cili parashikon, ndër të tjera, referuar: “Sistemit kontabël të përgjithshëm”, se dokumenti mandatarkëtimi, “[...] përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe duhet të përmbajë: a) emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial), si dhe datën; b) emërtimin e ndërmarrjes dhe të njësisë organizative brenda saj, që lëshon dokumentin, formën juridike dhe adresën e ndërmarrjes; c) tregimin e personit ose të njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimit, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe, në varësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave e të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare; ç) përshkrimin e përmbajtjes së treguesit sasiore dhe vlerorë; d) veprimet për shitjen e sendeve, furniturat, punimet dhe shërbimet e kryera për një veprimtari ekonomike, profesionale apo administrative dokumentohen në çdo rast me faturë”.

nga Drejtoria Rajonale Tatimore³⁶. Nga këto akte kanë rezultuar të dhëna për objektin e aktivitetit, kohën e themelimit dhe faktin që bashkëshorti i motrës është edhe ortaku i vetëm i saj. Në kushtet që Komisioni ka kryer hetim, sikurse edhe të arsyetimit të mësipërm për barazinë e përgjegjësive ndaj prindërve nga subjekti dhe e motra, trupi gjykues e vlerëson të ezauruar këtë aspekt. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të panevojshme të kryejë analizë financiare për mundësinë pague të motrës së subjektit për të mundësuar kujdesin shëndetësor të nënës së saj, në vijim të arsyetimit të mësipërm, si pasojë e të cilit shpenzimet e kryera nuk u vlerësuan, në rastin konkret, në kontekstin e përcaktimeve të pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të natyrës tejet specifike që shoqëron marrëdhënien e ngushtë prind-fëmijë dhe detyrimet e barabarta mes fëmijëve ndaj prindërve. Në përmbledhje dhe në vijim të arsyetimit të mësipërm, në analizën financiare të kryer në Kolegj, ky shpenzim nuk u përllogarit në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.

D. Kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale

15. Komisioni ka konkluduar se për shkak të *gabimeve thelbësore dhe serioze*, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të *gabuar*, subjekti ka treguar *mungesë* të aftësive profesionale. Po ashtu, sipas Komisionit, subjekti ka treguar cilësi të *papranueshme* në punë, *gjykim të dobët*, *vonesa dhe zvarritje* të gjykimeve, që çojnë në *cenim* të të drejtave të palëve dhe cenojnë besimin e publikut. Këto mangësi, në vlerësimin e Komisionit, nuk mund të rregullohen nga programi i trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës.

15.1. Subjekti nuk ka kundërshtuar në mënyrë specifike konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke u fokusuar kryesisht të argumentojë që në vlerësimin profesional të tij duhet të mbahet në konsideratë gjendja shëndetësore. Sipas subjektit, shkeljet e konstatuara nuk janë bërë në keqbesim apo për interesa të caktuara. Po ashtu, në kushtet që vlerësimi i aftësive profesionale për periudhën deri në vitin 2014 ka qenë objekt shqyrtimi i KLD-së e, më tej, është gjykuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rivlerësimi për këtë periudhë kohore sipas tij, cenon parimin e *gjësë së gjykuar*.

15.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet në fashikull përkundër shkaqeve të ankimit, vlerëson që konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Nga ana tjetër, argumentet e parashtruara nga subjekti në ankim për këtë kriter janë të pambështetura në ligj. Në këtë konkluzion, trupi gjykues u mbështet në një analizë rigorozë e të detajuar mbi bazën e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore, si dhe jurisprudencën e GjEDNj-së, që shtjellohet në vijim.

15.3. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit çmon se parimi i gjësë së gjykuar [*res judicata*] nuk gjen zbatim në rrethanat konkrete ligjore e faktike. Kufijtë e zbatimit të parimit të *gjësë së gjykuar* përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë kontekst, sillet në vëmendje se, sikurse ka elaboruar edhe GjEDNj-ja, koncepti i gjësë së gjykuar, në kontekstin e sigurisë juridike si parim themelor i shtetit të së drejtës, nënkupton verifikimin që çështjet e sjella përpara gjykatës të jenë identike e, me fjalë të tjera, verifikimin që konflikti gjyqësor zhvillohet mes të njëjtave palë dhe me të njëjtin objekt. Shkelja e këtij parimi vërtetohet

³⁶ Përkatësisht, shkresa nr. {***} prot., datë 06.03.2020, e QKB-së dhe e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë nr. {***} prot., datë 24.06.2020, drejtuar Komisionit.

nëse çështjeve që plotësojnë këto kushte u jepen zgjidhje të ndryshme³⁷. Në të njëjtën linjë edhe Gjykata Kushtetuese ka elaboruar se gjëja e gjykuar përfshin, jo vetëm urdhërimet e dispozitivit, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, të cilat janë në funksion të vendimit gjyqësor dhe iu përkasin fakteve ose marrëdhënieve që përbëjnë objektin e gjykimit, mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj³⁸.

15.4 Nga aktet në fashikull, rezulton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka marrë masë disiplinore për *shkarkim nga detyra* për subjektin e rivlerësimit, në vitin 2014. Sipas arsyetimit të KLD-së, subjekti është konstatuar me një vazhdë shkeljesh, të cilat cenojnë figurën e gjyqtarit. KLD-ja ka konstatuar përkeqësimin progresiv të gjendjes shëndetësore, në kontekstin e analizës së aftësisë së subjektit për të kryer detyrën. Pas ankimit të subjektit, me vendim të Gjykatës së Lartë, është kthyer çështja për rishqyrtim³⁹. Në vijim, bazuar edhe në mendimin e ekspertëve mjekoligjorë, në vitin 2015, KLD-ja ka marrë sërish masën disiplinore të *shkarkimit nga detyra* për subjektin. Motivacioni i masës disiplinore lidhet me konstatime të problematikave të punës së subjektit⁴⁰.

15.5 Mbi bazën e ankimit të subjektit, për herë të dytë, Gjykata e Lartë ka vendosur pranimin e kërkesës, *shfuqizimin* e masës së shkarkimit nga detyra dhe rikthimin në detyrë të subjektit⁴¹. Në vendimin e dytë të Gjykatës së Lartë, arsyetohet se vendimi i KLD-së [që shkarkoi subjektin nga detyra] ka mungesë koherence dhe kontradiksion të arsyetimit, por dhe mungesë argumentimi ligjor të masës disiplinore të marrë ndaj gjyqtarit. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i KLD-së ishte inkohorent, pasi shkarkimi nga detyra mund të vinte si pasojë e shkeljeve të rënda të vullnetshme ose për shkak të paftësisë fizike e mendore për të ushtruar detyrën, por jo për të dy këto alternativa njëherësh, siç ka argumentuar KLD-ja. Gjykata e Lartë ka konstatuar, po ashtu, se ekspertiza mjekoligjore ka treguar se subjekti/ankuesi kishte aftësi të kufizuara për të kryer detyrën, *por jo pamundësi për të punuar në detyrën e gjyqtarit*⁴². Në zbatim të këtij vendimi, në vitin 2016, subjekti është rikthyer në detyrë. Edhe pas arsyetimit në këtë analizë, nga fashikulli nuk rezulton që subjekti të ketë kërkuar reduktim të ngarkesës në punë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore apo të ketë ndërmarrë hapa të tjerë në vijim të konstatimit të mësipërm për rendiment pune të reduktuar⁴³.

15.6. Në analizë të sa më sipër, pikësëpari trupi gjykues i Kolegjit çmon të potencojë se nuk gjen vend situata procedurale e gjësë së gjykuar. Vlerësimi i kriterit profesional kryer në funksion të procesit të rivlerësimit, përkundër procesit disiplinor të kryer më herët nga KLD-ja [i kontrolluar nga Gjykata e Lartë], janë të ndryshëm, qoftë në kontekstin e kriterëve formale, sikurse edhe në atë të rrethanave konkrete e institucionale. Si premisë fillestare, trupi gjykues i

³⁷ Krivtsova k. Ruisë, 2022, §§ 42-48; Dechova et al k. Bullgarisë §§ 42-44 apo Kehaya et al k. Bullgarisë §§ 66-67.

³⁸ Vendimi nr. 24, datë 12.11.2008, i Gjykatës Kushtetuese.

³⁹ Vendimi nr. 4, datë 13.10.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁴⁰ “[...] gjyqtari Albano Çepele ka gjykuar 34 çështje me problematikë në afatin e dorëzimit të vonuar të arsyetimit të vendimeve. Nga verifikimi ka rezultuar se vendimet e 25 çështjeve janë dorëzuar tej afateve kohore të parashikuara në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 386 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa për 9 vendime të tjera ka rezultuar se nuk kanë qenë të dorëzuara në momentin e verifikimit, por edhe për këto vendime të pa dorëzuara është konstatuar se ka kaluar afati i arsyeshëm kohor brenda të cilit ato duhet të dorëzoheshin. [...]”.

⁴¹ Vendimi unifikues nr. 2, datë 11.04.2016.

⁴² Paragrafi 49 i vendimit supra.

⁴³ Ndër të tjerë, parashikuar në nenet 24, 27 e 67 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Kolegjit çmon të theksojë tagrat që kanë organet e rivlerësimit që të kryejnë hetim të pavarur e të gjithanshëm në secilin prej tri kriterëve të përcaktuara nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, në zbatim të qëllimit të kushtetutëbërësit që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

15.7. Në vijim të gjithë sa më sipër, në analizë të kriterëve përcaktuese të gjësë së gjykuar, konkretisht: (i) të njëjtat palë; (ii) i njëjti objekt; dhe (iii) i njëjti shkak dhe me fokus thelbin e mosmarrëveshjes⁴⁴, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

a. Në secilin nga dy proceset, palët janë të ndryshme. Konkretisht, në çështjen e gjykuar nga Gjykata e Lartë, palë janë subjekti i rivlerësimit nga njëra anë dhe KLD-ja nga ana tjetër. Procesi i zhvilluar nga KLD-ja nisi pas verifikimit të ankesave dhe inspektimit nga Inspektorati i Këshillit të Lartë i Drejtësisë, ndërsa procesin gjyqësor e nisi subjekti për të shfuqizuar shkarkimin nga detyra. Nga ana tjetër, në procesin e rivlerësimit kalimtar, palë është magjistrati/subjekti i rivlerësimit dhe procesi ka nisur *ex officio* për gjithë subjektet e rivlerësimit, në zbatim të pikave 3 dhe 4, të nenit 179/b të Kushtetutës, pasi plotësojnë deklaratën e pasurisë *vetting*, edhe shtojcat e tjera. Procesi zhvillohet nga Komisioni dhe Kolegji, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

b. Objekti i procesit të parë ishte kontrolli i vendimit dhe procedurës së ndjekur nga KLD-ja, për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit/subjektit të rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit, nga ana tjetër, ka për qëllim/objekt rivlerësimin kalimtar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi⁴⁵. Hetimi në procesin e rivlerësimit përfshin aspektin profesional, aspektin pasuror dhe atë të figurës. Në hetimin e vlerësimit të aspektit profesional për subjektin, Komisioni ka shqyrtuar në tërësi veprimtarinë profesionale të subjektit që nga viti 2006 – 2013, duke mos u kufizuar vetëm në raste të caktuara/izoluara.

c. Procedimi disiplinor i kryer nga KLD-ja, dhe në vijim ankimi i subjektit, kishte për bazë nga njëra anë kërkimin/shfuqizimin e masës disiplinore të bazuar në dispozitat ligjore të kohës, që rregullonin organizimin e funksionimin e KLD-së dhe atë të Gjykatës së Lartë, sikurse edhe parimet e procedimit disiplinor⁴⁶. Nga ana tjetër, kontrolli i kriterit profesional gjatë procesit të rivlerësimit bazohet në parashikimin e pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Me fjalë të tjera, vlerësimi profesional gjatë rivlerësimit është për shkak të statusit të tij si subjekt rivlerësimi dhe procesi është i ndryshëm nga procedimi disiplinor në KLD. Për këtë qëllim, Komisioni ka marrë dhe ka hetuar të dhënat nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke i analizuar rast pas rasti. Nga kjo analizë, Komisioni ka arritur edhe në rezultatin sipas germës “c”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016⁴⁷, në kuadër të procesit të

⁴⁴ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 29.03.2012: “[...] Shkaku i padisë është kombinimi i faktit cenus dhe i së drejtës subjektive mbi të cilën bazohet padia e që ka lidhje me marrëdhënien juridike që është themeli i pretendimit të paraqitur me kërkesëpadi në gjykatë”.

⁴⁵ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016.

⁴⁶ Neni 32 i ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, i shfuqizuar dhe germës “b”, të nenit 14 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” dhe Gjykata e Lartë gjykon në Kolegjet e Bashkuara: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

⁴⁷ “[...] c) “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi

vlerësimi të aftësive profesionale të subjektit, për të arritur në përmbushjen e qëllimit të këtij ligji [nr. 84/2016].

15.8. Vlerësimi i aspektit profesional të magjistratëve përfshin analizën e veprimtarisë së tyre, për të përmbushur qëllimin kushtetues të këtij procesi. Qenia e subjektit në detyrën e gjyqtarit nënkupton se ai i nënshtrohet procesit të *jashtëzakonshëm* të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim të këtyre dispozitave, vlerësimi i kriterit profesional nga Komisioni për subjektin ka përfshirë të gjithë veprimtarinë e tij dhe jo çështje të caktuara të trajtuara nga KLD-ja. Së fundmi, procesi i rivlerësimit është i ndryshëm nga procesi disiplinor i zakonshëm, që përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2016 kryhej nga KLD-ja, aktualisht është tagër e KLGj-së dhe përfshin zhvillimin e karrierës së magjistratëve. Nga ana tjetër, rivlerësimi kalimtar u vlerësua një nevojë e diktuar nga situata në të cilën ndodhej sistemi i drejtësisë në vend. Për sa më lart, është e qartë që nuk gjen zbatim situata e *gjësë së gjykuar*, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, për cenimin e garancisë së sigurisë juridike, gjendet i pabazuar.

15.9. *Së dyti*, trupi gjykues i Kolegjit e gjen, po ashtu, të pabazuar pretendimin e subjektit se nuk duhet të shoqërohet konstatimi i shkeljeve me pasojë në rastin e tij, meqenëse shkeljet *nuk janë kryer me keqbesim apo për interesa të caktuara*. Nga ana tjetër, trupi gjykues konkludon që analiza e kryer nga Komisioni për mungesën e efikasitetit në punë të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e pasojave që shkeljet kanë pasur për të drejtat e palëve në proces, është e drejtë. Analiza e trupit gjykues shtjellohet në vijim.

15.10. Kriteret mbi të cilat bazohet vlerësimi i aftësisë profesionale janë përcaktuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, nuk rezulton në asnjë rast që prezumimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të kushtëzohet nga konstatimi i keqbesimit apo nga konstatimi i arsyeve për të cilat janë kryer shkeljet e që të passjellin analizën nëse ka vend zbatimi i saj [masës disiplinore]. Përkundrazi, vlerësimi i aftësisë profesionale për gjyqtarët [...] përfshin *aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj [...]*⁴⁸. Nga ana tjetër, prezumimi në favor të masës disiplinore gjen zbatim në raste specifike të konstatimit të papërshtatshmërisë për të kryer funksionin për *njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme ose [...] mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij apo kur subjekti i rivlerësimit [...] rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime ose një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve*⁴⁹. Në të njëjtën linjë, edhe dispozitat e nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 kushtëzojnë analizën e kryer për vlerësimin profesional, duke mbajtur në fokus cilësitë në punë, gjykimin dhe respektimin e të drejtave të palëve në proces⁵⁰. Në përmbledhje, parë në nivel parimor, si Kushtetuta ashtu edhe ligji nuk parashikojnë si kriter vendimmarrjeje hetimin e arsyeve për të cilat kanë ndodhur shkeljet e konstatuara.

i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës”.

⁴⁸ Pika 2, e nenit E të Aneksit të Kushtetutës.

⁴⁹ Pikat 4 dhe 5 të të njëjtës dispozitë.

⁵⁰ Neni 44 përcakton: “Relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve e tjera ligjore. Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë: [...] c) “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave,

15.11. Nga leximi harmonik i këtyre dispozitave, sikurse edhe atyre të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), rezulton që vlerësimi i punës së magjistratëve duhet të fokusohet, ndër të tjerë, në analizën nëse mënyra e kryerjes së detyrës ka passjellë cenimin e të drejtave të palëve në proces, shkallën e seriozitetit të kësaj gjendjeje dhe, së fundmi, nëse problematika e konstatuar mund të shërohet nëpërmjet trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës. Ky konkluzion është në të njëjtën linjë edhe nëse mbahet në konsideratë që gabimet që mund të shfaqë një magjistrat në kryerjen e detyrës, parimisht prezumohen të jenë në mirëbesim. Në të kundërt, rrethanat ligjore nuk do të përkonin me vlerësimin në kontekstin disiplinor, siç rezulton qartë nga alternativat e përcaktuara nga neni E i Aneksit të Kushtetutës. E thënë ndryshe, situata e keqbesimit ose dyshimet eventuale të një qasjeje të asaj natyre do të shtroheshin detyrimisht në drejtim të abuzimit me detyrën, në kontekstin penal. Për këto arsye, pretendimi i subjektit, për mungesë keqbesimi, paraqitet si një tentativë për të relativizuar e minimizuar shkeljet e konstatuara të kryera prej tij, që kanë passjellë cenim të të drejtave të palëve e që në thelb e kategorizojnë atë në situatën e parashikuar nga pika 5, e nenit E të Kushtetutës dhe germës “c”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Si të tilla, parë edhe në këtë plan, pretendimet e subjektit janë të pabazuara.

15.12. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues të Kolegjit mban në vëmendje edhe aspekte të jurisprudencës së GjEDNj-së, lidhur me gjykimin brenda një kohë të arsyeshme dhe përgjegjësitë e gjykatës në garantimin e respektimit të këtij parimi, si pjesë e përgjegjësisë që kanë gjykatat për të përmbushur këtë detyrim ligjor:

[...] Megjithatë, [sipas mendimit të Gjykatës], ky parim nuk funksionon të përjashtojë gjykatat nga sigurimi i gjykimit të shpejtë të padisë siç kërkohet nga neni 6 të Konventës.

[...] Për më tepër, gjykatat mbajnë përgjegjësi për sigurimin e përmbushjes së kërkesave kohore të arsyeshme të nenit 6, pika 1, të Konventës, veçanërisht duke përdorur kompetencat e tyre për të kundërshtuar çdo taktikë vonese nga palët në procedim⁵¹.

15.13. Në bazë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile⁵² [përmbajtja e nenit që ka qenë në fuqi në momentin e kryerjes së veprimeve], parashikohej një afat maksimal 10-ditor i zbardhjes/arsyetimit të vendimeve, për çështje të ndërlikuara. Në analizë të të dhënave kohore, lidhur me dhënien dhe zbardhjen e vendimeve, referuar informacionit të dërguar Komisionit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁵³, rezulton se prej vitit 2006 deri në vitin 2013, nga 3394 vendime të shpallura nga subjekti i rivlerësimit, 851 janë zbardhur tej afatit ligjor. Mesatarisht, 23% e punës 8-vjeçare është në tejkalim të afatit. Vërehet që performanca e subjektit të rivlerësimit ka rënë me kalimin e viteve, duke e ulur produktivitetin, në një masë nga 12% në vitin 2006, duke arritur në 46% në vitin 2013, pa shkaqe të arsyeshme e në mënyrë të përsëritur.

nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit [...].

⁵¹ Çështja *Guincho kundër Portugalisë*, parag. 32, dhe çështja *Costa Ribeiro kundër Portugalisë*, parag. 29. (citimi i përkthyer nga anglisht).

⁵² Neni 308 parashikonte: “[...] Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në pesë ditë. [...]”.

⁵³ Shkresa nr. {***} prot., datë 19.06.2020, e Gjykatës së Rrethit Shkodër.

Këto të dhëna u vlerësuan nga trupi gjykues si një ndër aspektet e të drejtave të palëve në proces, duke mbajtur në konsideratë edhe testin prej katër elementësh të elaboruar nga GjEDNj-ja për të verifikuar ndikimin e sjelljes së autoriteteve të vendit në kohëzgjatjen e procesit⁵⁴. Ndër aspektet e prekura nga kjo jurisprudencë, ka referenca të mjaftueshme për efektin e vonesave në zbardhjen e vendimeve⁵⁵, shkaktuar nga vetë gjykata, kundrejt kohëzgjatjes në total të procesit dhe pasojat në kërkimin e të drejtës për palët, sikurse edhe pasojat e dinamikës së veprimeve që kanë qenë nën kontrollin e gjykatës.

15.14. Nga aktet në fashikull rezultojnë se ndër pesë (5) dosje gjyqësore të shortuara dhe analizuar për kriterin e aftësive profesionale nga KLD-ja⁵⁶, tri (3) çështje janë ankimuar. Në këto tri çështje⁵⁷, nga gjykata më e lartë dy (2) janë kthyer për rigjykim për shkelje *procedurale*, që përfshijnë vlefshmërinë e akteve procedurale. Gjykata e Apelit ka konstatuar shkelje të respektimit të njoftimit të palëve në proces, në kushtet që ka vijuar gjykimi në mungesë dhe hetim të plotë.

15.15. *Së treti*, trupi gjykues i Kolegjit e çmon të pakuptimtë pretendimin e subjektit se problematikat e konstatuara në kriterin e vlerësimit profesional mund të korrigjohen nëpërmjet trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës. Subjekti ia atribuon këto mangësi gjendjes së tij shëndetësore, për të cilën rezultojnë të jetë diagnostikuar më së paku në vitin 2010⁵⁸. Po ashtu, subjekti nuk rezultojnë të ketë paraqitur kërkesë për uljen e ngarkesës në punë për shkak të sëmundjes e, për më tepër, nuk ka akte në fashikull që të dokumentojnë se është cilësuar *me aftësi të kufizuara*, në mënyrë që të reduktohej ngarkesa në punë, në përputhje me konkluzionin e raportit mjekoligjor të kryer me kërkesë të KLD-së gjatë procesit të dytë disiplinor në vitin 2015, sipas së cilit produktiviteti në punë është ulur në masën 3.5%, për shkak të sëmundjes. Sjellim në vëmendje, që për herë të parë subjekti e ka parashtruar këtë argument në një fazë relativisht të avancuar të procesit të rivlerësimit, në fund të seancës dëgjimore, si argument i gjetjeve për kriterin e vlerësimit profesional. Trupi gjykues e vlerësoi këtë aspekt në drejtim të besueshmërisë së pretendimeve të subjektit, si mjet i përdorur prej tij për të përmirësuar pozitën e tij në procesin e rivlerësimit.

15.16. Analiza e parashikimeve ligjore ndër vite tregon që subjekti e ka pasur, në teori, mundësinë për të kërkuar ulje të ngarkesës në punë. Konkretisht, ndërsa rregullimet në fuqi deri në vitin 2016 nuk parashikonin shprehimisht të drejtën për të kërkuar ulje të ngarkesës në punë,

⁵⁴ König kundër Republikës Federale Gjermane [1978], §99 dhe, ndër të tjera, Delic kundër Kroacisë, §102: “Gjykata rithekson se arsyeja e kohëzgjatjes së procedimit duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në çështjen e gjykatës, në veçanti, kompleksitetin e çështjes, zhvillimin e kërkuesit dhe i autoriteteve përkatëse dhe rëndësia e asaj që është në rrezik për kërkuesin në procesin gjyqësor”.

⁵⁵ Ndër të tjerë, B. Kundër Austrisë, §52; Massa kundër Italisë, §16.

⁵⁶ Në referencë të pikës 4 të Sistemit të vlerësimit, që përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, parashikon: [...] Standardi cilësor i punës nënkupton cilësinë e gjykimeve të një gjyqtari të dhëna brenda një viti kalendarik në raport me kontrollin gjyqësor të tyre të realizuara nga gjykatat me te larta, ku numri i vendimeve të cenuara nuk duhet të kalojë masën e 30 % të vendimeve të ankimuara. [...].

⁵⁷ Dosja nr. 4, faqe 788 e vijim.

⁵⁸ U diagnostikua me sëmundjen “{***}”, sipas raportit mjekësor të datës 22.02.2010 të lëshuar nga Dr. J. K. - Shërbimi i {***} pranë QSUNT-së.

ligji nuk parashikonte ndalim⁵⁹. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016⁶⁰, janë parashikuar lehtësira, ndër të tjera, edhe për shkak të gjendjes shëndetësore të magjistratëve. Konkretisht, nga leximi harmonik i neneve 26 dhe 27 të këtij ligji, subjekti gëzonte të drejtën për të përfituar deri në 75% të ngarkesës në punë, sikurse edhe pensionin e parakohshëm, për shkaqe shëndetësore. Ligji parashikon në nenin 24 edhe të drejtën e magjistratëve për të përfituar leje të papaguar deri në dy vjet, përfshirë për arsye shëndetësore, me miratim nga KLGj-ja. Ligji parashikon edhe rastin e caktimit të përkohshëm, kur një magjistrat nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin, për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për arsye të parashikuara nga ligji [nenet 59 dhe 60], që nënkupton përcaktimin ligjor në detaj të mënyrës sesi përballohet ngarkesa në punë për raste mungesash të përligjura të magjistratëve, ndonëse për periudha relativisht të shkurtra kohore. Së fundmi, pamundësia fizike a mendore e magjistratit për ushtrimin e funksionit, parashikuar në nenin 67 të ligjit nr. 96/2016, mund të çojë në largim nga funksioni ose pezullim të përkohshëm nga detyra. Procedura kryhet me autorizim të KLGj-së, nga ekspertë të specializuar të cilët japin mendim për pamundësinë. Në çdo rast, magjistrati gëzon të drejtën e rikthimit në funksion, nëse vërtetohet që pamundësia nuk ekziston më.

15.17. Nga sa më sipër, edhe nëse abstragohet nga mungesa e shprehur e ligjit të mëparshëm, rezulton që duke filluar nga nëntori 2016, subjekti i rivlerësimit kishte mundësinë ligjore që të materializonte në praktikë nëpërmjet organit përkatës të qeverisjes së gjyqësorit nevojën për ngarkesë të reduktuar apo masa të tjera që lejon e parashikon ligji. Në fakt, siç është shtjelluar më sipër, kjo nuk ka ndodhur. Për më tepër, subjekti nuk ka argumentuar apo sjellë dokumentacion mbështetës as pranë organeve të rivlerësimit. Nuk rezulton që subjekti të ketë vënë në dijeni për këtë situatë as edhe Kryetarin e Gjykatës së Rrethit Shkodër, i cili mund të merrte masa apo mbante në konsideratë këtë rrethanë në hedhjen e shortit dhe mbikëqyrjen e ngarkesës së gjyqtarëve, sikurse as KLD-në apo KLGj-në. Me fjalë të tjera, institucionet përkatëse të qeverisjes së gjyqësorit nuk janë vënë në lëvizje për të vlerësuar/konkluduar pamundësinë e plotë apo të pjesshme të subjektit për të ushtruar detyrën, me kërkesë apo me vërtetim të organit kompetent (KMCAP). Po ashtu, pavarësisht nga hyrja në fuqi në nëntor 2016 e rregullimeve ligjore të detajuara, ndonëse i qartë për sfidat me të cilat shoqërohej rendimenti i tij në punë dhe mangësitë me pasoja për palët, ndër të tjera, edhe për shkak të procedurës së përsëritur në KLD në vitet 2014-2016, subjekti për herë të parë e ngriti pretendimin për paaftësi shëndetësore që pamundësonte kryerjen e detyrës vetëm katër (4) vite më pas, në nëntor 2020 dhe pasi u përball me një vlerësim të pafavorshëm në përfundim të hetimit administrativ nga Komisioni.

15.18. Nga aktet në fashikull, rezulton se as edhe gjatë hetimit administrativ subjekti *nuk* ka argumentuar dhe as mbështetur kërkesat e tij procedurale që lidhen me gjendjen e tij konkrete shëndetësore. Si rrjedhojë, Komisioni ka aplikuar të njëjtat kritere si për subjektet e tjera që janë përfshirë në procesin e rivlerësimit *ex officio*, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës. Në aspektin procedural, subjektit i është dhënë kohë shtesë pas dy (2) kërkesave të tij, respektivisht me gjashtë (6) ditë dhe shtatë (7) ditë⁶¹, për paraqitjen e mbrojtës dhe provave. Ndonëse subjekti nuk paraqiti prova dhe prapësime për disa çështje të hetuara, Komisioni ka

⁵⁹ Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar, i shfuqizuar nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

⁶⁰ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/10/06/96-2016>

⁶¹ Subjekti nuk ka përcaktuar për sa kohë ka nevojë, por e ka lënë në vlerësim të Komisionit.

kryer hetim të plotë për të tria kriteret e vlerësimit. Nga ana tjetër, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, në llogaritjen e afateve të proceseve gjyqësore të zhvilluara nga subjekti, në funksion të vlerësimit të vonesave procedurale, Komisioni rezulton të ketë marrë në konsideratë edhe mungesat, si për shkak të sëmundjes, ashtu edhe çdo mungesë tjetër në punë. Në të paktën një nga çështjet e përzgjedhura me short, Komisioni ka konstatuar që ndonëse tre seanca gjyqësore janë shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit, në fakt ai rezulton të ishte në punë⁶².

15.19. Komisioni nuk e ka lënë jashtë vëmendjes gjendjen shëndetësore të subjektit, siç është shpjeguar më sipër. Në ankim subjekti kërkoi që t'i nënshtrohet parametrave të ndryshëm të kontrollit nga ata të parashikuar për gjyqtarët e tjerë. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se në zbatim të dispozitave ligjore të fushës, organet e rivlerësimit nuk kanë tagrat ligjore për të verifikuar gjendjen shëndetësore të subjekteve. Po ashtu, në kushtet që nuk ka një akt të organit kompetent që të vërtetojë që subjekti cilësohet *i paaftë për punë ose me aftësi të kufizuara*, organet e rivlerësimit nuk mund të ndjekin një procedurë të ndryshme përpos asaj të parashikuar nga kushtetuta e ligji për të gjithë subjektet e rivlerësimit.

15.20. Në këto kushte, duket jobindës argumenti i subjektit se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore, ndërkohë veprimet e atij vetë për t'iu nënshtuar një regjimi të ndryshëm në përmbushje të detyrimeve dhe privilegjeve që gëzonte si magjistrat mungojnë tërësisht. Nuk rezulton që subjekti të ketë argumentuar në ankim sesi ai është diskriminuar kundrejt subjekteve të tjera për të cilët është kryer kontrolli i kriterit të vlerësimit profesional. Në kushtet kur gjatë veprimtarisë së tij, subjekti nuk rezulton ta ketë materializuar këtë nevojë të shtuar të tij për kohë shtesë apo për një normë të reduktuar çështjesh, që mban në konsideratë gjendjen e tij shëndetësore apo që KLD/KLGj-ja të jetë përballur me kërkesë të tij në këtë drejtim, pretendimi për diskriminim mbetet i pambështetur. Më së fundmi, subjekti do të duhet të kishte prapësuar vlerësimin e Komisionit në vijim të barrës së provës, gjë që nuk ka ndodhur. Në këto kushte, ky pretendim vlerësohet i pabazuar.

15.21. Nga analiza e cilësive të mbrojtura nga neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁶³, deduktohet se diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore do të përfshihej teorikisht në grupin *ose çdo statusi tjetër*. Kjo bazë ligjore mbrojtëse, gjithsesi nuk do të gjente zbatim në rrethanat konkrete, në kushtet që subjekti nuk ka kërkuar të gjejë zbatim në nivel institucional kjo cilësi apo kufizim aftësish për rastin e tij. Nga ana tjetër dhe përpos këtij konstatimi, trupi gjykues sjell në vëmendje që në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, diskriminimi duhet të shoqërohet me shkelje të njërës nga nenet e Konventës ose të Protokollit⁶⁴, aspekt që, po ashtu, nuk rezulton të jetë potencuar apo provuar nga subjekti apo nga kontrolli i

⁶² Paragrafi 31.4.2.1 në vendimin e Komisionit, analiza e çështjes civile nr. {***}.

⁶³ Neni 14 – Ndalimi i diskriminimit – Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja *ose çdo status tjetër*. Ndërsa neni 18 i Kushtetutës parashikon: “[...] 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. [...]”.

⁶⁴ Thlimmenos kundër Greqisë (2000) - 40. Gjykata rikujton se neni 14 i Konventës nuk ka ekzistencë të pavarur, pasi ai ka efekt vetëm në lidhje me të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga dispozitat e tjera thelbësore të Konventës dhe Protokollit e saj.

vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi ta analizojë këtë pretendim të subjektit për diskriminim, të lidhur me nenet 6 e 8 të Konventës.

15.22. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit, thekson se subjekti nuk kundërshtoi përfundimet e Komisionit për kriterin profesional për secilën nga gjetjet, ndërsa gjatë seancës dëgjimore pretendoi që sistemi mbështetës i gjykatave dhe infrastruktura në Republikën e Shqipërisë nuk është i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara, siç e cilësoi ai veten në atë seancë. Nën dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së, sipas së cilës, diskriminimi mund të lindë kur shtetet, pa një justifikim të arsyeshëm, dështojnë të trajtojnë ndryshe persona, situatat e të cilëve janë dukshëm ndryshe⁶⁵, organet e rivlerësimit nuk mund të mos vijonin me kryerjen e procesit *ex officio*, sikurse edhe për subjektet e tjerë, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë procedurë të parashikuar nga ligji për të përfituar nga reduktimi i ngarkesës. Përkundrazi, rezultoi që subjekti ka zgjedhur të vijojë të ushtrojë funksionin pa asnjë ndryshim nga magjistratët e tjerë që janë subjekte të procesit të rivlerësimit kalimtar. Nga ana tjetër, nga sa ka referuar subjekti në seancën dëgjimore, gjykata ku ai ushtron detyrën, në fakt i ngarkon për gjykim çështje që përfshihen në sferën e marrëdhënieve familjare, që [sipas tij] nuk kanë kompleksitet, çka nënkupton krijimin e kushteve që subjekti të ushtrojë detyrën e gjyqtarit në përputhje me mundësinë e tij. Ky akomodim në nivel *informal* duket të ketë ndodhur, ndonëse subjekti nuk rezultoi të ketë paraqitur asnjë kërkesë për të pasur trajtim të veçantë, si në ambientin e punës, ashtu edhe në Komision.

15.23. Duke aplikuar arsyetimin në *Farcaş kundër Romanisë*⁶⁶, ku GjEDNj-ja e ka trajtuar diskriminimin për shkak të sëmundjes të lidhur me nenin 6 të Konventës, trupi gjykues i Kolegjit thekson se pa anashkaluar gjendjen shëndetësore të subjektit, në kushtet që ai kishte mundësi dhe mjete efektive për të aksesuar gjykatën, në rastin konkret Komisionin, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, nuk gjen vend të argumentohet se ka një cenim të nenit 14 e, për pasojë, pretendimi për diskriminim është i pabazuar. Subjekti i rivlerësimit ka caktuar avokat me tagra të pakufizuara në drejtim të përfaqësimit dhe mbledhjes së provave pranë institucioneve, që në nëntor të vitit 2017. Gjithashtu, sipas prokurës së posaçme të përfaqësimit, datë 20.01.2020, është caktuar avokati Y. K. që të përfaqësojë subjektin gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, në prezencë dhe në mungesë. Në kushtet që avokati mund të mbledhte prova dhe të dhëna të tjera në mbrojtje të interesit të subjektit të rivlerësimit, pretendimi për cenim të nenit 14, lidhur me nenet 6 dhe 8 të Konventës për mbrojtje efektive, mbetet i pabazuar në ligj dhe në rrethanat faktike.

16. Në përmbledhje të sa më lart, pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit që lidhen me këtë kriter, trupi gjykues konstaton që konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mangësive të cilat nuk mund të rregullohen me program trajnues nga Shkolla e

⁶⁵ *Supra*. Paragrafi nr. 44, faqe 8 dhe *Beard v. Britanisë së Madhe* – paragrafi 131 dhe 132 i vendimit.

⁶⁶ <https://hudoc.echr.coe.int/eng-press?i=003-3270987-3667739>, (aplikimi nr. 32596/04). Nenet 6/1 dhe 34, vetëm ose në lidhje me nenin 14: “[...] Në rastin konkret, Gjykata arriti në përfundimin se as e drejta e aksesit në gjykatë dhe as e ngritjes së padisë nuk ishin penguar nga pengesa të pakapërcyeshme që e pengonin kërkuar të ngrerit procedime ose të paraqitjes së kërkesës ose të komunikimit me Gjykatën. Ai mund të kishte ngritur procedime para gjykatave ose autoriteteve administrative me postë, nëse ishte e nevojshme nëpërmjet një ndërmjetësi. Posta lokale ishte e aksesueshme dhe, në çdo rast, qasja në të nuk ishte e domosdoshme për postimin e letrave. Asistenca e një avokati nuk ishte e nevojshme për të nisur procedimin në fjalë dhe kërkuar mund të kishte kontaktuar gjithmonë me letër ose faks, ose mund të kishte bërë një kërkesë në gjykatë për ndihmë juridike falas. Së fundi, nuk ishte vërejtur asnjë paraqitje e trajtimit diskriminues ndaj aplikantit. [...]”.

Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit rezulton me aftësi profesionale, gjykim, qëndrime dhe një model pune të tillë që ka cenuar të drejtat e qytetarëve e, për pasojë, konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Nën dritën e përcaktimeve të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 44, germa “c” dhe nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duhet të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Ky konkluzion mban në konsideratë sa vijon:

16.1 Nga analiza e akteve të marra në shqyrtim nga Komisioni, në funksion të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, përpos vonesave dhe zvarritjeve të proceseve gjyqësore, edhe në ditët kur subjekti ka qenë i pranishëm në punë, rezultojnë problematika të përsëritura që lidhen me mënyrën e organizimit të procesit, mënyrën e administrimit të provave, mungesës së arsytimit dhe aftësisë së zbatimit të normës ligjore, si dhe vendimmarrje haptazi në shkelje të ligjit, vendimmarrje që nuk përputhen me kërkimet e palëve, që janë të cekëta e të papranueshme dhe cenojnë dhënien e drejtësisë. Në këtë këndvështrim, pas kontrollit të analizës së vendimit të Komisionit për veprimtarinë profesionale të subjektit, rezultoi se: (i) subjekti ka kryer shkelje procedurale, ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta, gjykim të dobët, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar, ka cenuar të drejtat e palëve për të ushtruar të drejtën e ankimit, ka treguar cilësi të papranueshme në punë për gjykim të drejtë, nuk është treguar efektiv, si dhe ka cenuar solemnitetin e gjykimit; (ii) vonesat në zbardhjen e vendimeve kanë cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta; si dhe (iii) ka tejkaluar afatet në të gjitha rastet e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit të vendimeve, duke cenuar të drejtën e palës për një proces të rregullt, nëpërmjet pengimit të ekzekutimit në kohë të vendimit.

16.2 Nga e njëjta analizë rezulton se në mënyrë të përsëritur, në ushtrimin e detyrës, subjekti ka cenuar të drejtat e palëve për proces të rregullt ligjor, të cilat demonstrohen në formën e shkeljes së parimit të gjësë së gjykuar, vendosjes në fashikull të provave, të cilat nuk ka gjurmë se si janë bërë pjesë e dosjes gjyqësore, shkeljes së të drejtës së palëve për të marrë pjesë në gjykim, nëpërmjet të cilave rezulton një mënyrë gjykimi dhe arsytimi e papranueshme për një gjyqtar.

16.3 Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit thekson se pasi u njoh me rezultatet e hetimit në Komisioni subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime për rezultatet e vlerësimit të kriterit profesional. Pretendimet e subjektit, që ia atribuojnë këto problematika serioze profesionale gjendjes së tij shëndetësore, janë ngritur në një fazë të avancuar të procesit, ndonëse i referohen një diagnoze të njohur prej tij dhe mund të ishin adresuar në institucionet përgjegjëse, më së paku, duke filluar që nga nëntori i vitit 2016. Subjekti rezulton se ka zgjedhur të heshtë deri në seancën dëgjimore në Komision, për të favorizuar situatën e tij në procesin e rivlerësimit, në probabilitetin që në varësi të situatës, të parashtronte gjendjen e tij shëndetësore si justifikim kundrejt vijimit të ushtrimit të detyrës, pavarësisht nga problemet e përsëritura e të theksuara të konstatuara ndër vite në performancën e tij. Këto fakte nga trupi gjykues i Kolegjit u vlerësuan përkundër faktit që subjekti ishte magjistrat karriere e, si i tillë, pritet të ketë qartësi për të drejtat e tij dhe detyrimet që e shoqërojnë, në funksion të dhënies së drejtësisë për qytetarët, sikurse edhe qartësi për institucionet të cilat kanë tagra për t'i shqyrtuar e rregulluar këto situata në balancë me interesin publik. Për më tepër, subjekti ishte përballur me situatën e tij shëndetësore përgjatë procedimit disiplinor edhe në KLD. Për pasojë, ky argument duhet të ngrihej menjëherë në Komisioni, nëse kjo ka qenë arsyeja e defekteve të konstatuara në vlerësimin e kriterit të

aftësive profesionale. Paraqitja e këtyre pretendimeve për herë të parë në seancën dëgjimore e, më tej, në ankim dhe parashtrime, rezulton si një përpjekje e subjektit për të paraqitur fakte në favor të situatës procedurale të tij dhe trupi gjykues i vlerëson këto pretendime të pabazuara. Për rrjedhojë, këto rrethana janë të tilla që e kualifikojnë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

17. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime dhe shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Albano Çepele nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe përshtatshmëri në atë profesional. Për pasojë, nën dritën e pikave 1 dhe 3, të nenit D dhe nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe pikat 3 dhe 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramentit të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë dhe i papërshtatshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.
18. Për sa më lart, vendimi nr. 317, datë 20.11.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të neni 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 317, datë 20.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Albano Çepele.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 21.06.2023.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi